

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PERLA RESORT PROPERTY MANAGEMENT” SH.P.K

Sot në datë 09.04.2021, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë ortaket :

- **Znj. Suela Spahija** , e bija e Ylvi , lindur më 29.06.1979, në Shkoder dhe banues në Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Kartes se Identitetit me Nr. Personal H95629165B ;
- **Z. Eldar Kopliku** , i biri i Luan, lindur me 22.07.1984, ne Tirane dhe banues ne Tirane ne madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i Kartes se Identitetit me nr personal I40722027H;

Kane vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është **“PERLA RESORT PROPERTY MANAGEMENT” SH.P.K**

Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë është në adresën : Durrës, Ishem, Lalez, Kompleksi Turistik Perla Resort

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Sherbime te ndryshme ne fushen e hotelerise dhe turizmit. Dhenie me qera te ambienteve te ndryshme per pushim. Ofrimin e sherbimeve te tipit, bar kafe, ambiente argetimi, fusha sportive, pishina.etj. Administrim dhe sherbime mirembajtjeje te ambienteve te perbashketa ne komplekse rezidenciale.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë **Znj. SUELA SPAHIJA**, në vlerën 50.000 (pesdhjetë mijë) leke, përkatësisht 50% (pesdhjetë) përqind të kapitalit të shoqërisë dhe **Z. ELDAR KOPLIKU** në vlerën 50.000 (pesdhjetë mijë) lekë, përkatësisht 50% (pesdhjetë) përqind të kapitalit të shoqërisë, Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota të barabarta, me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim;

Neni 7- Administratorët

Me këtë Akt emërohen Administratorët e shoqërisë personat si më poshtë:

- **Znj. Suela Spahija**, e bija e Ylvi, lindur më 29.06.1979, në Shkoder dhe banues në Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr. Personal H95629165B;
- **Z. Eldar Kopliku**, i biri i Luan, lindur më 22.07.1984, në Tirane dhe banues në Tirane madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr personal I40722027H
 - Administratorët kanë të drejtë që veprimet bankare të kryejnë vecmas nga njëri tjetri ose pa kufizim shumash.

- Afati i emerimit ne detyre per secilin nga administratoret eshte 5 vjet me te drejte riemerimi.

Neni 8 – Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është i përbërë në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKET E SHOQËRISË

“PERLA RESORT PROPERTY MANAGEMENT” SH.P.K

Znj. SUELA SPAHIJA



Z. ELDAR KOPLIKU



Tiranë më, 08/04/2021